



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 345/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Xhevdet Smakiqi kandidat për deputet nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër komisionarëve të Vendvotimeve 2130-01R dhe 2130-02D, në fshatin Prekaz i Ulet komuna e Skenderajt, për shkak të mungesës të votave në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës te datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Xhevdet Smakiqi, kandidat për deputet nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër komisionarëve të Vendvotimeve 2130-01R dhe 2130-02D, në fshatin Prekaz i Ulet komuna e Skenderajt, për shkak të mungesës të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës te datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 07.10.2019, nga Xhevdet Smakiqi, kandidat për deputet nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër komisionarëve të Vendvotimeve 2130-01R dhe 2130-02D në fshatin Prekaz i Ulet komuna e Skenderajt, në të cilën pretendon se procesi i numërimit të votave në këto vendvotime është shoqëruar me parregullsi të numërimit të votave e cila ndikon në rezultatin zgjedhor në këtë qendër të votimit ku si pasoj nuk janë evidentuar votat. Paraqitësi i ankesës pretendon se i mungojnë votat e farefisit të tij me mbiemrin Meha , Ahmeti dhe Jashari. I njëjti kërkon nga PZAP-i që ta aprovoj ankesën dhe ta autorizoj KQZ-ne të bëjë rinumërimin e kutive të votimit për vendvotimet e lartcekura.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive në ditën e votimit, për shkak se përmes kësaj ankese atakohet rezultatit i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrahet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hudhet poshtë e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për hudhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejudikon rezultatit përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë/apelojnë rezultatit përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 345/2019 më datën 08.10.2019



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.